



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 83-Maj- 2010 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>





Përmbajtja:

Nis aksioni i spërkatjes së terrenit për eliminimin e rrigrave	3
Kryetari Kilaj mbështet qytetarë	4
Muaji prill, ishte muaji më i qetë në aspektin e sigurisë u vlerësua në KKSB.....	4
QPS shënoi 20 vjetorin e themelimit dhe punës së saj.....	5
Po ndërtohen dy shkolla dhe disa fusha sportive	6
Të fillojnë përgatitjet për hartimin e buxhetit për vitin 2011	7
Një grup parlamentarësh zviceran vizituan Malishevën	7
KPF mbajti mbledhjen e katërt të radhës.....	9
Kryetari Kilaj:“Investimi në arsim, është investim në ardhmërinë e kombit”.....	10
Kryetari Kilaj i shpreh ngushëllime familjes Avdiaj nga Llapqeva.....	11
Përurohet fusha e sportit në SHMU “Migjeni” në Lubizhdë.....	12
Komuna përkrah pemëtarët.....	13
Premton kompletimin e infrastrukturës shkollore.....	14
Këshilli i Drejtorëve diskuton për përgatitjet e 16 Qershorit	15
Kvale dhe Hoxhaj, vizituan qendrën e Kompetencës në Malishevë	16
MPMS dhe Komuna nënshkruajnë marrëveshje për rregullimin e shtratit të përroskës së qytetit.....	17

Nis aksioni i spërkatjes së terrenit për eliminimin e rriqrave

Malishevë, 4 maj

Nga dita e sotme, ka filluar implementimi i projektit për spërkatjen e zonave endemike, për eliminimin e rriqrave, si masë preventive, kundër etheve hemorragjike.

Ky projekt është hartuar dhe po implementohet nga Qeveria e Malishevës, ndërsa është financuar nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës, i mbikëqyrur nga Instituti Rajonal i Shëndetit Publik në Prizren.



I tërë projekti do të zgjasë 30 ditë, ku do të përfshihen 39 zona endemike, ndërsa sot ka filluar nga fshati Mleqan, nga i cili fshat gjatë vitit të kaluar janë regjistruar dy raste të vdekjeve nga ethet hemorragjike dhe disa të tjerë të infektuar, për të vazhduar më pas në zona tjera endemike në territorin e komunës së Malishevës.

Në këtë projekt, janë të përfshira katër grupe për spërkatje selektive, ku përveç stafit të

trajnuar, gjithsejtë njëzetetë (23) që do të bëjë kryejnë këtë aksion, janë të përfshirë edhe ekspert nga IRSHP në Prizren dhe stafi i QKMF-së në Malishevë.

Përveç spërkatjes, në këtë projekt janë përfshirë edhe ligjëratat për vetëdijesim të qytetarëve për rrezikun nga thumbimi i rriqrave.

Ky është rasti i parë e marrjes së masave preventive kundër etheve hemorragjike, të cilat barten tek njeriu përmes rriqrave dhe minjve.



Nga takimi i rregullt me qytetarë

Kryetari Kilaj mbështet qytetarë

Malishevë, 6 maj

Në takimin e sotëm, tashmë të zakonshëm me qytetarë, kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, është njoftuar me hallet dhe preokupimet e tyre, me ç'rast ka dhënë udhëzime dhe përkrahje morale e institucionale, varësisht prej rasteve.

Për dallim nga ditët tjera, sot pritja e palëve ka filluar që nga ora 9:00 e mëngjesit, ndërsa ka vazhduar si zakonisht deri në orën 12:00. Hallet e qytetarëve kanë qenë nga më të ndryshmet.

Për të gjitha shqetësimet e prezantuara nga ana e qytetarëve, z. Kilaj ka dhënë përgjigjet e mundshme. Do të thotë i ka udhëzuar ata se ku të drejtohen për raste të caktuara, pastaj se ku ti orientojnë kërkesat e tyre për institucionin që ai udhëheqë, etj. Ndërkohë që i ka njoftuar palët se sektorët e qeverisë që ai udhëheqë, përveç tjerash janë duke u marrë edhe në aspekte të ndryshme, por edhe me grumbullimin e të dhënave për raste që kanë të bëjnë me problemin e banimit.

Muaji prill, ishte muaji më i qetë në aspektin e sigurisë u vlerësua në KKSB

Malishevë, 6 maj

Në mbledhjen e sotme të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), situata e sigurisë së përgjithshme, u vlerësua e qetë dhe stabile, përderisa sipas Policisë së Kosovës, gjatë muajit prill ka pasur më së paku aksidente dhe raste të shkaktit të veprave penale apo kundërvajtjeve.

Nga drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim është njoftuar për fillimin e spërkatjes së zonave që konsiderohen më endemike, në lidhje me paraqitjen e rriqrave dhe pasimin e etheve hemorragjike.

“Në bashkëpunim me drejtoritë komunale për shëndetësi dhe bujqësi, kemi filluar implementimin e projektit për spërkatjen e zonave endemike, për eliminimin e rriqrave, si masë parandaluese kundër etheve hemorragjike”, ka njoftuar përgjegjësi për preventivë në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Ejup Zulfaj.

U.D. i komandantit të stacionit policor në Malishevë, togeri Bekim Begaj, ka njoftuar për situatën e sigurisë në territorin e komunës së Malishevës, ku sipas raporteve policore, gjatë muajit të kaluar, janë shënuar 19 aksidente në trafik me 11 të lënduar, si dhe janë



regjistruar 20 vepra penale, të ndryshme, mirëpo në përgjithësi situata e sigurisë nga ana e tij është vlerësuar e qetë dhe stabile.

“Gjatë prillit, kemi realizuar edhe një projekt, kryesisht me moshat e reja, projekt (fushatë) antidrogë, me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve dhe të rinjve, për pasojat e përdorimit të narkotikëve”, ka thënë togeri Begaj.

Edhe anëtarët tjerë të KKSB-së e kanë vlerësuar të qetë dhe stabile situatën e sigurisë së përgjithshme, por kanë trajtuar temën e gjendjes jo të mirë të ambientit, si pasojë e hedhjes së mbeturinave në vende publike, si dhe nevojën e një organizimi më të mirë të grumbullimit të mbeturinave.

Vlen të theksohet se që nga sot, anëtar i KKSB-së, do të jetë edhe një përfaqësues i Forcës së Siguri të Kosovës (FSK).

QPS shënoi 20 vjetorin e themelimit dhe punës së saj

Malishevë, 11 maj

Me një solemnitë rasti, me pjesëmarrjen edhe të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), kryetarit të komunës dhe simotrave të saj nga komunat fqinje Qendra për Punës Sociale (QPS) në Malishevë, ka shënuar 20 vjetorin e themelimit dhe të punës së saj në Malishevë.

“Uroj që të kemi sa më pak njerëz me gjendje sociale, por uroj edhe që ekipi juaj profesional të vazhdoj edhe më tej ti kryej detyrat e veta në mënyrë profesionale”, ka thënë Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, me rastin e kremtimit të kësaj date të rëndësishme, për punën e QPS-së.

Drejtori i QPS-së, Blerim Begaj, ka njoftuar për punën e këtij institucioni, që për qëllim ka zbutjen e varfërisë, përkujdesjen për rastet sociale dhe ofrimi i ndihmës për këtë kategori.

“Komuna është ajo që më së miri bënë identifikimin e nevojave të qytetarëve të saj prandaj është bërë ky decentralizim”, ka thënë Muhamet Gjocaj, drejtor i departamentit për Mirëqenie Sociale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), duke e vlerësuar si hap të rëndësishëm bartjen e kompetencave nga kjo ministri tek komunat, ndërkohë që ka premtuar ndihmën e mëtejme të kësaj ministrie.

Në këtë përvjetor, Skënder Hoti, drejtor në DSHMS si dhe Blerim Begaj drejtor në QPS kanë ndarë mirënjohje për ata që e kanë ndihmuar këtë institucion në mesin e të cilëve edhe KFOR-in dhe OSBE-në, por mirënjohje u janë ndarë edhe Faik H. Morinës, Bali Krasniqit dhe Isuf Vrenezit që janë ndër punëtorët më të hershëm të kësaj qendre.

Po ndërtohen dy shkolla dhe disa fusha sportive

Malishevë, 13 maj

Kanë filluar dhe po vazhdojnë punimet në ndërtimin e dy shkollave fillore dhe të mesme të ulët dhe tri fusha sportive, në pesë fshatra të komunës së Malishevës, në kuadër të përpjekjeve të Komunës, për përmirësimin dhe krijimin e kushteve më të mira për mësim, në shkollat tona.

Momentalisht, janë duke u ndërtuar shkollat fillore dhe të mesme të ulët në fshatin Senik, si dhe në fshatin Banjë, kjo e fundit e përcjellë me infrastrukturë të kompletuar, ndërsa punimet janë në fazën e ndërtimit të kateve të para, ndërsa priten të jenë të gatshme me 1 shtator, për fillimin e procesit mësimor për vitin akademik 2010-2011.



Po ashtu në kuadër të përmirësimit dhe krijimit të kushteve më të mira si dhe ndërtimit të infrastrukturës përcjellëse nëpër shkolla, komuna po rregullon edhe ambientet e jashtme, gjegjësisht, ndërtimin e fushave sportive, ku aktualisht janë në fazën përfundimtare fushat



sportive në shkollat e fshatrave, Ngucat, Lumishtë dhe Llazicë.

Tri fushat e sportit dhe shkolla në Senik, janë duke u ndërtuar nga buxheti i komunës së Malishevës, ku janë ndarë 124 926 euro për fushat e sportit dhe 312 928 euro për shkollën në fshatin në fshatin Senik, ndërsa shkolla e Banjës është donacion i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Punimet janë duke i kryer kompanitë “Beli”(fushat e sportit) dhe “Arbëri”(shkollën në Senik).

Të fillojnë përgatitjet për hartimin e buxhetit për vitin 2011

Malishevë, 17 maj

“Përgatitjet për hartimin e buxhetit për vitin 2011, duhet të fillojnë nga tani, në mënyrë që ti kemi planifikimet për vitin e ardhshëm, pasi mund të ketë telashe, për shkak të ngarkimeve shtesë të buxhetit komunal, llogaritur këtu në hapjen e Qendrës së Kompetencës dhe obligimet tjera”, ka thënë kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, në mbledhjen e radhës së Këshillit të Drejtorëve.

Për këtë kryetari Kilaj, ka kërkuar angazhim të drejtorive për planifikimet buxhetore për vitin 2011, pasi edhe për vitin e ardhshëm komunës sonë, do ti ndahet buxheti për vetëm 52 mijë banor dhe jo sa është numri real i banorëve të Malishevës.

Ndërsa në lidhje me një grant që USAID-i ka ndarë për komunën e Malishevës, në vlerë prej 45 mijë dollarë, kryetari Kilaj, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit, caktimin e projektit për krijimin e hapësirave të gjelbëruara në qytet.

Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, kryetari i komunës ka kërkuar që të filloj procedurat për sigurimin e një kompanie për mirëmbajtjen e ndriçimit publik në Malishevë, ndriçimin dhe mirëmbajtjen e varreza të dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë, si dhe për mirëmbajtjen e lapidarëve në tërë territorin e Malishevës.

Në këtë takim të radhës, nga drejtori i shëndetësisë, z. Skënder Hoti, është njoftuar edhe për vazhdimin e projektit për spërkatjen e zonave endemike, ku sipas drejtorit për shëndetësi, deri më tani ka përfunduar spërkatja në nëntë fshatra dhe bazuar në situatën në terren, efekti është i dukshëm, pasi nuk është regjistruar asnjë rast i thumbimit të rrigrave, nga zonat ku ka përfunduar spërkatja.

Një grup parlamentarësh zviceran vizituan Malishevën

Malishevë, 18 maj

Një delegacion i lartë i shtetit zviceran, i përbërë nga parlamentar dhe ushtarakë të lartë zvicerane, kanë vizituar Malishevën, konkretisht kontingjentit e LMT-së



zvicerane që vepron në komunën e Malishevës.

Nikoqir të këtij delegacioni ka qenë LMT në Malishevë, ku të ftuar ishin edhe kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj me bashkëpunëtorët e tij.

Takimi ka qenë me karakter njohës dhe shkëmbim përvojash, me ç'rast z. Kilaj, në rolin e kryetarit të komunës i ka njoftuar për rrjedhat e përgjithshme në Malishevë, zhvillimin ekonomik, ndihmën dhe bashkëpunimin me pjesëtarët e KFOR-it zviceran.

Delegacioni zviceran ishte i përbërë nga 12 parlamentar dhe zyrtarë të lartë të ushtrisë së këtij shteti mik, ishte i udhëhequr nga parlamentari z. Bruno Frick, i cili duke e përshëndetur këtë takim, tha se Kosova dhe Zvicra kanë bashkëpunim të mirë, ndërsa gjuha shqipe, sipas të tij, është njëra ndër gjuhët që flitet më së shumti në Zvicër, për arsye të numrit të madh të shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë në Zvicër.

“Ju jeni punëtor të mëdhenj, ndërsa edhe gjatë luftës së fundit në Kosovë, një numër i madh i kosovarëve, kanë gjetur strehim në Zvicër, prandaj Zvicra, mundohet ti jap shtytje Kosovës, që të ec përpara”, ka thënë në fjalën e tij, udhëheqësi i delegacionit zviceran, parlamentari Bruno Frick.

Kryetari i komunës së Malishevës e ka vlerësuar lartë kontributin e Zvicrës, në çlirimin e Kosovës, por edhe pas luftës, duke u shprehur se “ në gjithë historinë e Kosovës Zvicra ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm, prandaj ne edhe sot jemi të lumtur dhe me fat që një pjesë e trupave zvicerane janë të vendosura në territorin e Komunës së Malishevës. Ata janë të domosdoshëm për sigurinë dhe perspektivën evropiane të Kosovës. Trupat zvicerane janë si në shtëpinë e tyre këtu në Malishevë, sepse të tillë e konsideron populli ynë, si pjesë të historisë tonë, në shtetin tonë në Republikën e Kosovës”, kështu është shprehur, mes tjerash kryetari i komunës së Malishevës në fjalimin e tij, drejtuar parlamentarëve zviceran dhe trupave të KFOR-it, LMT, në Malishevës.

Pas këtij fjalimi z. Bruno Frick, është shprehur i kënaqur me vlerësimin e kryetarit të Malishevës, në adresë të shtetit të Zvicrrës. “Jam i ndikuar nga fjalët e juaja dhe e keni fjalën time, se ne do të vazhdojmë t’ju ndihmojmë dhe këtë do ta bëjmë me dëshirë”, ka thënë z.Frick. “Pavarësia ka qenë me shumë rëndësi për juve dhe rruga juaj është e gjatë dhe e mundimshme”, tha ai, duke u shprehur gjithashtu se gjatë vizitës këtu, kanë vërejtur se të gjitha komunitetet i kanë të drejtat e barabarta.

Parlamentari Frick, ka vlerësuar lartë edhe punën e Policisë së Kosovës dhe i ka inkurajuar që të vazhdojnë me këtë formë të mirë të punës, në mënyrë që të jenë shembull për punët të mirë. Ndërsa, ka bërë të ditur se qëllimi i vizitës së tyre është, vlerësimi i gjendjes faktike në terren, zhvillimin ekonomik dhe politik, në mënyrë që të kenë një opinion të qartë për zhvillimet këtu, pasi në fund të vitit të ardhshëm duhet të vendosin, nëse ka nevojë që trupat e KFOR-it zviceran të qëndrojnë apo jo në Kosovë.



Adem Jashari, në Sheshin e Dëshmorëve.

“Ne e dimë se KFOR-i do të largohet një ditë, por dëshirojmë të jemi të fundit”, ka përfunduar z. Flick duke e apostrofuar këtë fjali si komplimentin më të mirë që ai ka dëgjuar për ushtarët zviceran me detyrë në komunën e Malishevës.

Delegacioni zviceran i shoqëruar edhe nga ai i komunës së Malishevës, ka bërë një vizitë përgjatë qendrës së qytetit të Malishevës, si dhe kanë vizituar shtatoren e Komandantit Legjendar

KPF mbajti mbledhjen e katërt të radhës

Malishevë, 19 maj

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), ka mbajtur mbledhjen e katërt të radhës, ku janë shqyrtuar dhe janë rekomanduar për Kuvend Komunal, draft rregullorja mbi transparencën komunale, si dhe dy kërkesa të grupit parlamentar të LDK-së.

Anëtarët e KPF-së e kanë quajtur mjaft të kompletuar draft rregulloren mbi transparencën, ndërsa kanë kërkuar disa sqarime, të cilave iu është përgjigjur, këshilltari ligjor i kryetarit të komunës, Muharrem Morina.

Po ashtu për kuvend janë rekomanduar edhe dy kërkesa të grupit parlamentar të LDK-së, e para për drejtorinë për arsim dhe kërkesa tjetër që ka të bëjë me pyetje parlamentare.

Më pas janë shqyrtuar disa kërkesa të qytetarëve, por jo edhe kërkesat për çështje materiale.

Kjo mbledhje e KPF-së, është monitoruar nga KDI, përderisa është vëzhguar edhe nga një grup nxënësish nga shkolla e mesme profesionale “Lasgush Poradeci” në Kijevë, të cilët më pas edhe kanë bërë pyetje në drejtim të kryesuesit Ragip Begaj dhe anëtarëve të tjerë të KPF-së, për mënyrën e punës së komitetit dhe për detyrat që ka ky organ i kuvendit.

U përurua shkolla në fshatin Tërpezë

Kryetari Kilaj: “Investimi në arsim, është investim në ardhmërinë e kombit”.

Malishevë, 21 maj



Në mënyrë solemne, sot u bë përurimi i objektit të shkollës fillore dhe të mesme të ulët “Hasan Prishtina” në Tërpezë, një nga investimet e shumta të komunës së Malishevës në infrastrukturën shkollore, investim ky për të cilin kryetari i komunës së Malishevës z. Isni Kilaj theksoi se, investimi në arsim, është investim në ardhmërinë e kombit.

“Ndihem shumë mirë që sot po bëjmë përurimin e shkollës. Komuna e Malishevës ka

investuar më së shumti në arsim dhe do të vazhdojmë me këtë ritëm, pasi investimi në arsim, është investim në ardhmërinë e kombit”, ka thënë Kilaj, në fjalimin e tij me rastin e përurimit të kësaj shkolle.

Ndërsa drejtori i arsimit, z. Isuf Morina, tha se investimet në këtë fushë duhet edhe të arsyetohen, ndërsa kjo shkollë e ka arsyetuar këtë investim në garat kombëtare të diturisë. Objekti i shkollës fillore dhe të mesme të ulët “Hasan Prishtina”, është investim i Komunës së Malishevës, vlera e këtij investimi është 360 mijë euro, ndërsa punimet i ka kryer kompania ndërtimore “Arbëri”.

Shiritin e përurimit e prenë, kryetari Isni Kilaj, drejtoresha e shkollës Rajmonda Krasniqi, veterani i arsimit Sali Krasniqi, etj., ndërkohë që u shfaq edhe një program kulturo-artistik, nga nxënësit e shkollës.

Kryetari Kilaj i shpreh ngushëllime familjes Avdiaj nga Llapqeva

Malishevë, 24 maj

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, ka shprehur keqardhjen e tij për rastin e humbjes së jetës së një fëmije 11 vjeçar nga Llapqeva, ku në emër të tij dhe Qeverisë Komunale i ka shprehur ngushëllimet më të sinqerta familjes Avdiaj nga Llapqeva.

Kryetari Kilaj, ka kërkuar vazhdimin e projektit për spërkatjen selektive të zonave endemike, duke kërkuar edhe angazhim shtesë dhe sigurim të medikamenteve, si dhe ka kërkuar ndihmë nga institucionet qendrore të vendit.

“Le të vazhdoj spërkatja pa marrë parasysh kushtet atmosferike në të gjitha zonat endemike, le të sigurohen sasi tjera të medikamenteve dhe le të shtohet doza që përdorët për eliminimin e rriqrave”, ka kërkuar Kilaj nga përgjegjësit e projektit.



Drejtori i shëndetësisë, Skënder Hoti, ka konfirmuar edhe zyrtarisht rastin e vdekjes së Y. Avdiaj, përderisa ka raportuar për 222 raste të thumbuar nga rriqrat, të cilët kanë kërkuar ndihmë mjekësore në QKMF të Malishevës. Njëkohësisht është raportuar edhe për së paku dy raste me ethe hemorragjike që janë trajtim në klinikën infektive, përderisa ka apeluar që qytetarët ti përmbahen udhëzimeve për masat mbrojtëse.

Në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve është trajtuar edhe Qarkorja Buxhetore për vitin 2011 si dhe janë trajtuar edhe çështje tjera.

Pas mbledhjes, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka lëshuar edhe një deklaratë për opinion, lidhur me situatën e krijuar pas vdekjes së një fëmije nga ethet hemorragjike.

Në vijim deklarata:

Në emër të Kryetarit të Komunës së Malishevës, Isni Kilaj dhe në emër të Qeverisë Komunale, familjes Avdiaj nga Llapqeva i shprehim ngushëllimet më të sinqerta, pas



humbjes së djalit të tyre, nga ethet hemorragjike “krime kongo”. Kjo është një epidemi e cila na shqetëson dhe vazhdimisht merr jetë njerëzish, pothuajse çdo vit.

Duhet të pranojmë se kjo është viktima e dhjetë nga ethet hemorragjike.

Përmes kësaj deklarate, iu bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve të komunës së Malishevës, që të mos jenë neglizhent në rastet e atakimeve nga rriqrat, për arsye se kjo po na kushton shumë rëndë. Andaj lusim të gjithë qytetarët, që t’ju përmbahen udhëzuesve ku përshkruhen masat mbrojtëse nga ethet hemorragjike.

Në kontaktin e parë me rriqra, duhet të lajmëroheni menjëherë në QKMF në Malishevë dhe assesit të mos i largoni vet rriqrat.

Duke ju falënderuar një punë të palodhshme dhe shumë profesionale të mjekëve dhe punëtorëve shëndetësorë të Malishevës, edhe pse nuk janë përgjegjës, bëjnë punë shumë profesionale nga përvoja që kanë fituar si rezultat i rasteve të shpeshta. Po ashtu falënderojmë edhe Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, në veçanti Institutin Regjional në Prizren, pasi për herë të parë kemi marrë iniciativë për spërkatje kolektive të 39 zonave endemike, si masë parandaluese, ku përgjegjësia kryesore është e IKSHIP-së, gjegjësisht e Institutit Regjional të Shëndetit Publik në Prizren që në bashkëpunim me punëtorët shëndetësorë të Malishevës, po bëjmë spërkatjen dhe IRSHP, e mbikëqyr në tërësi projektin.

Në të njëjtën kohë, epidemiologët që janë në teren, po mbajnë ligjërata në shkolla dhe me qytetar për masat mbrojtëse dhe pasojat e kësaj sëmundje. Përmes radios së vetme lokale, çdo ditë njoftohen qytetarët për masat mbrojtëse nga ethet.

Mirëpo, ne e dimë që projekti i cili është duke u implementuar këtë vit, nuk mund të ketë rezultate pozitive të menjëhershme, pasi kjo epidemi kërkon një luftim të vazhdueshëm disa vjeçar. Për këtë arsye, kemi filluar këtë vit dhe shpresojmë në mbështetjen e Qeverisë së Kosovës, kryesisht nga Zyra e Kryeministrit, që të na mbështet përsëri në vazhdimin e këtij projekti edhe në vitet e ardhshme. Për këtë do të drejtohem me kërkesë, Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrisë së Shëndetësisë, pasi mendojmë se ky është një problem në nivel vendi.

Komuna e Malishevës

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtori: Skënder Hoti

Përrurohet fusha e sportit në SHMU “Migjeni” në Lubizhdë

Malishevë, 26 maj

Sot me rastin e shënimit të 62 vjetorit të SHMU “Migjeni” në Lubizhdë, është përruruar edhe fusha e sportit e kësaj shkolle, e cila është ndërtuar në kuadër të investimeve të komunës në infrastrukturën shkollore dhe krijimin e kushteve më të mira për punë dhe mësimnxënie.

“Përveç sukseseve të mira që po tregohen nga shkollat tona, po përmirësohet edhe infrastruktura shkollore, si në ambientet e brendshme ashtu edhe në ambientet e jashtme, duke krijuar kushte gjithnjë e më të mira për nxënësit”, ka thënë në fjalën e rastit, drejtori i arsimit në komunën e Malishevës, Isuf Morina.



“Kjo vatër e dijes sot po shënon 62 vjetorin, vatër nga e cila kanë emra të mëdhenj dhe ne e falënderojmë komunën, pasi tani kemi standarde më të larta për mbarëvajtjen e mësimi”, ka thënë drejtori SHMU “Migjeni”, Rrahim Paçarizi.

Shiritin e përrurimit e kanë prerë drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Isuf Morina dhe drejtori i kësaj shkolle, z. Rrahim Paçarizi, ndërsa topin e parë në fushë e ka gjuajtur kryetari i komunës, z. Isni Kilaj.

Me rastin e shënimit të 62 vjetorit të SHMU “Migjeni”, është dhënë edhe një program artistik, nga nxënësit e kësaj shkolle, si dhe është hapur një ekspozitë nga fusha e artit figurativ, ku janë prezantuar punimet më të mira të nxënësve të kësaj shkolle.

Komuna përkrah pemëtarët

Malishevë, 27 maj

Kryetari i Komunës, z. Isni Kilaj dhe drejtori për bujqësi Sinan Kryeziu, në kuadër të përkrahjes së komunës, për kultivuesit e pemëve dhe rrushit, sot kanë përkrahur kultivuesin Alban Hoti, nga Carralluka, i cili ka të mbjellë 70 ari me rrush dhe 70 ari me pemë tjera, ndërsa është përkrahur me dy spërkatëse, në mënyrë që të ketë më të lehtë spërkatjen e kësaj sipërfaqeje.



“Unë do të përkrahi të gjithë kultivuesit e pemëve dhe rrushit, në forma të ndryshme, në mënyrë që të kemi sa më shumë sipërfaqe të punuara dhe të gjelbëruara, përderisa nga kjo veprimtari edhe jetohej shumë mirë në aspektin ekonomik”, ka thënë kryetari Kilaj, duke ju bërë thirrje edhe të tjerëve, që të merren me këtë veprimtari.

Përndryshe, kryetari

Kilaj, edhe viteve tjera ka përkrahur përmes mjeteve për punë, disa nga kultivuesit e pemëve nga komuna e Malishevës.

Alban Hoti, përfitues i sotëm i përkrahjes, ka falënderuar kryetarin Kilaj për mbështetjen e tij që po u jep kultivuesve. “Çdo përkrahje është jo vetëm e mirë por edhe një motiv shtesë për kultivimin e pemëve, rrushit apo kulturave tjera”, ka thënë Hoti.

“Duhet të kemi kësi kryetari, që vjen drejt në vend, ulen në tokë dhe bisedon për punën, për telashet që ne kemi si kultivues, dhe në të njëjtën kohë neve na përkrahë”, tha Dalip Hoti.

Përndryshe, kultivuesi Alban Hoti, ka të mbjellë 70 ari me rrush tryeze “Muskat Italian”, përderisa ka edhe 70 ari të tjerë me kumbulla, dardha dhe mollë, kurse planifikon të mbjellë edhe disa hektar me rrush, dhe në të njëjtën kohë shpreson edhe në përkrahje nga ana e Ministrisë së Bujqësisë.

Kryetari Kilaj prit nxënësit e klasë së IV-të nga Seniku

Premton kompletimin e infrastrukturës shkollore

Malishevë, 28 maj

Kryetari i Komunës së Malishevës z.Isni Kilaj, ka pritur sot në zyrën e tij, nxënësit e klasës së katërt nga fshati Senik, me ç’rast iu është premtuar përfundimi i objektit të ri shkollor deri më 1 shtator, ndërsa deri në fund të mandatit të tij, edhe kompletimin e infrastrukturës shkollore.

Nxënësit e kësaj klase, kanë bërë një vizitë në institucione lokale, në kuadër të procesit së tyre mësimor, nga lënda e edukatës qytetare, me ç'rast kanë takuar Kryetarin e Komunës, drejtorin e arsimit, gjykatat dhe stacionin e policisë në Malishevë, ku janë njoftuar me organizimin e qeverisjes lokale.

Kryetari Kilaj, i ka njoftuar nxënësit me strukturën organizative, nivelin e qeverisjes lokale, punët që kryhen në komunë, obligimet ndaj qytetarëve dhe çështje të tjera. Gjithashtu iu është përgjigjur edhe pyetjeve të parashtruara nga nxënësit, që kishin të bënin me shkollën tyre, me ç'rast kryetari u ka premtuar se pas objektivit të shkollës, brenda mandatit të tij qeverisës, do të kompletoj këtë shkollë dhe shkollat tjera edhe me infrastrukturën përcjellëse, si kabinete dhe fusha sportive.

Po ashtu Kilaj, u ka thënë nxënësve se, ata mund ti realizojnë ëndrrat e tyre në jetë duke i këshilluar se kjo mund të arrihet me punë, konkretisht me angazhimin e tyre në mësim.

Nxënësit në këtë vizitë kanë qenë të shoqëruar nga mësuesja e tyre Albulena Sahitaj.



Këshilli i Drejtorëve diskuton për përgatitjet e 16 Qershorit

Malishevë, 31 maj

Në mbledhjen e sotme (të rregullt) të Këshillit të Drejtorëve, të udhëhequr nga kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, në mesin e shumë çështjeve, është diskutuar edhe për përgatitjet për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Është diskutuar kompletimi i Këshillit Organizativ, sipas vendimit të Asamblesë Komunale, nga mbledhja e kaluar, për përbërjen e tij me përfaqësues të partive politike, që pritet të plotësohet me emrat gjatë ditës së sotme, si dhe për çështjet financiare për organizimin e shënimit të datës më të rëndësishme për Komunën e Malishevës.

Në këtë mbledhje, po ashtu janë diskutuar dhe janë bërë njoftimet për aktivitetet e komunës dhe drejtorive përkatëse, ku sipas kryetarit të komunës, z. Isni Kilaj, gjatë ditës së sotme, do të nënshkruhet një marrëveshje në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për një investim në rregullimin e përroskës në qytet, e cila lidhet me lumin Mirusha.

Po ashtu është diskutuar edhe pjesëmarrja e drejtorëve në mbledhjen e fundit të Asamblesë Komunale, situata epidemiologjike dhe vazhdimi i projektit për spërkatjen selektive, që është duke u bërë në territorin e komunës së Malishevës, si dhe për vazhdimin e këtij projekti, përfundimit të tij, por edhe ndarja e mjeteve shtesë nga ana e qeverisë komunale për këtë çështje.

Kvale dhe Hoxhaj, vizituan qendrën e Kompetencës në Malishevë

Malishevë, 31 maj

Ambasadori i Norvegjisë Sverre Johann Kvale dhe Ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj, të hënë, kanë inspektuar punimet në Qendrën e Kompetencës në Malishevë ku janë



njoftuar për së afërmi me punimet që janë duke u zhvilluar.

“Jam i kënaqur me ecurinë e punës dhe më 1 Shtator presim të hapen për mësim këto dy shkolla”, ka deklaruar ambasadori norvegjez, Sverre Johann Kvale, pas vizitës që ka bërë në këto dy shkolla. “Arsyeja e investimit është e thjeshtë, një shtet i ri me mundësi të reja. Këto shkolla do t’ju mundësojnë të rinjve të gjejnë vende pune”, tha Kvale, duke arsyetuar investimet në këto qendra. Ndërsa sa i përket stafit menaxhues dhe atij mësimor, Kvale ka shprehur bindjen dhe kënaqësinë e tij për mënyrën e zgjedhjes së stafit. “Jam i bindur që njerëzit e zgjedhur janë kompetent”, tha Kvale.

Ndërtimin e këtyre objekteve, ministri Hoxhaj e ka vlerësuar si meritë e ambasadës dhe personalisht ambasadorit norvegjez.

“Për neve si ministri, reformat në arsim janë të domosdoshme dhe këto reforma janë si rezultat i zhvillimit ekonomik. Për neve edukimi është ekonomi dhe ekonomia është edukim. Në kuadër të kësaj shkollat profesionale lidhen direkt me përgatitjen e të rinjve për tregun e punës dhe janë faktor kyç për zhvillimin ekonomik të Kosovës”, ka thënë ministri Hoxhaj, duke i arsyetuar investimet në këto dy shkolla.

Sipas ministrit Hoxhaj, Qendrat e Kompetencës në Malishevë dhe Skenderaj, në të gjitha aspektet, janë më modernet në Ballkan.

“Këto shkolla do të jenë shembull dhe inspirim për të tjerët dhe për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe besoj se do të jetë inspirim edhe për faktorët tjerë ndërkombëtar për investim në shkollimin profesional, ndoshta investime edhe më shumë se vet buxheti i MASHT-it”, tha Hoxhaj. “Këto dy shkolla do ta ndryshojnë edhe perceptimin e qytetarëve për arsimin profesional, arsim i cili në të kaluarën është shikuar ndryshe, por ne kemi nevojë edhe për fuqi punëtore, që është në gjendje të ushtroj profesione të ndryshme, direkt në tregun e punës”, ka deklaruar ministri Hoxhaj.

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, as kësaj here nuk ka kursyer fjalënderimet ndaj Qeverisë së Norvegjisë dhe ndaj Ambasadorit të saj në Kosovë, z. Kvale, por as ndaj Ministrisë së Arsimit dhe ndaj ministrit Enver Hoxhaj, për këtë investim që po bëjnë në qytetin e Malishevës, me rastin e ndërtimit të kësaj Qendre të Ekselencës.

MPMS dhe Komuna nënshkruajnë marrëveshje për rregullimin e shtratit të përroskës së qytetit

Malishevë, 31 maj

Kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj dhe ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Nenad Rashi, kanë nënshkruar sot marrëveshjen për rregullimin e shtratit përroskës së qytetit të Malishevës.



Kjo marrëveshje është nënshkruar në lokalet e ministrisë, ndërsa i tërë projekti, i cili do të financohet nga MPMS, kushton 100.053 €.

Brenda kësaj marrëveshje janë të përfshira disa kritere, të cilat duhet të përfillen si nga ministria, po ashtu edhe nga ana e komunës.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, do të transferon mjetet financiare, në kodin e llogarisë së komunës, do të publikoj konkurse për vende pune përmes Zyrës së Punësimit dhe do t'i ofroj kompanisë përfituese të realizimit të projektit përmes komunës listën e punëtorëve për përzgjedhjen e tyre sipas kritereve të përcaktuara në manual. Kështu thuhet në mes tjerash, në marrëveshjen e nënshkruar nga përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe lokale, për sa i përket disa nga obligimeve që janë të parapara për MPMS. Ndërsa obligimet që duhet ti zbatoj komuna, kanë të bëjnë më këto kushte:

- projekti të përfundoj para datës 31 dhjetor 2010;
- që 40% të shpenzimeve nga projekti të jenë të dedikuara për të punësuarit;
- në projekt duhet të angazhohen së paku 50% e punëkërkuesve përmes Zyrave të Punësimit; dhe
- që kohëzgjatja e të punësuarve duhet të jetë minimum 3 muaj.